



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 35 Date 22/09/ 2017

Për

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Ljusa”, nga subjekti “ Diezela ” shpk, Lumi Mat Përroi i zallit të madh degë e Përroit të Ljusës degë e Lumit Mat në Fshatin Gjalish, Bashkia Mat, Qarku Dibër.

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 te ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”(i ndryshuar), me propozim te A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat,**

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “ Diezela ” shpk, me Administrator Z.Kujtim Mersinaj, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike” sipas studimit të paraqitur nga subjekti “ Diezela “ shpk, me këto të dhëna:

HEC LJUSJANA

- Subjektit juridik/fizik “ DIEZELA” shpk:
- Përroi i Zallit të Madh të Lumit Mat , me vendodhje në: Bashkia Mat, Qarku Dibër.
- Prurja mesatare : $Q= 1.96 \text{ m}^3/\text{sek}$,
- Prurja llogarites: $Q= 2.5 \text{ m}^3/\text{sek}$,
- Prurja ekologjike: $Q= 0.318 \text{ m}^3/\text{sek}$,
- Prurje per perdorime te tjera: _____ m³
- Energjia e planifikuar vjetore: 8.6 Gwh/vit,
- Fuqia 1980 kw,ore pune/vit 4432
- Kuota e vepres se marrjes Z- 445 m, X-44 27 978 Y-46 09 740
- Kuota e godines se centralit: Z-345m. X- 44 24 808 Y- 46 09 672

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT

Ast **NIKOLLA**



KRYETARI I K.B.U. MAT

Eduard **NDRECA**

